

BASHKIA M/
Zyra e Protokollit
Nr. 799 Protokollit
Date 01.04.2019 Nenshkrimi
R. G. 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. akti 460

Korce, me: 26.03.2019

S H K R E S E- percjellese

Bashkise Maliq

Lutemi vendoseni njerën nga kopjet e shpalljes së njoftimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce dt.26.03.2019 për njoftimin e të paditues Aleksa Dhimitri për datën e orën e seances gjyqësore, që po u dergojmë në vendin tuaj të afishimit, e tjetren dergojeni perseri në adresë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce me konfirmimin e afishimit të shpalljes.

GJYQTARE
ARIOLA KRISTO



Alexis
Z. Informimit Publik
01.04.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. akti 460

Korce, me: 26.03.2019

Shpallje

Ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korce, po gjykohet çështja civile me nr. Regj. Them. 460 me pale ndërgjyqëse:

Padites: Endri Kociu

E paditur: Aleksa Dhimitri

Objekti: Zgjidhje martesë etj.

Gjykates i rezulton se e paditura Aleksa Dhimitri, me adresë të vendbanimit zyrtar në Maliq, Blloku nr.2 si dhe me adresë të vendbanimit faktik në Erseke, nuk ndodhet në banesë, por është larguar jashtë shtetit.

Fakti i mesiperm i qenies së saj jashtë shtetit është konfirmuar nga të dhënat e sistemit TIMS për të.

Në keto kushte e në mbështetje të nenit 133/a, pika(b) e 133/b të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka vendosur njoftimin e të paditues të mesipërme me shpallje publike me afat 20 ditë, duke shpallur (afishuar) atë në ambientet e dukshme të gjykates; në Bashkinë Maliq, në territorin e së cilit ajo ka pasur vendbanimin e fundit zyrtar para largimit jashtë shtetit; në Bashkinë Kolonjë, në territorin e së cilit ajo ka pasur vendbanimin e fundit faktik të ditur para largimit jashtë shtetit; në vendin ku ajo ka pasur vendbanimin e fundit zyrtar para largimit jashtë shtetit, pra në Maliq, Blloku nr.2 (derën e shtëpise), në vendin ku ajo ka pasur vendbanimin e fundit faktik të ditur para largimit jashtë shtetit, pra në Erseke (derën e shtëpise) si dhe do të botohet në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykates.

Me afishimin e kësaj shpallje vihet në dijeni e paditura Aleksa Dhimitri, për zhvillimin e séances gjyqësore me datë 25.04.2019, ora 09.00, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korce. Me kalimin e afatit 20-ditor, nëse i padituri i mesiperm, ose ndonjë perfaqësues i tij me prokurë nuk paraqitet në gjykatë, gjykata zhvillon gjyqin në mungesë.

Kjo shpallje zëvendëson njoftimin (komunikimin) e rregullt për të padituren Aleksa Dhimitri

U afishua në Bashkinë Maliq në dt _____.

Administratori _____
(emer, mbiemer, firmë)

GJYQTARE
Ariola Kristo